



## PROCESVERBALI

Mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) në Rahovec, e mbajtur më **12.06.2019** me fillim në ora **10.10**. Mbledhjen e kryesoi nënkryetari Komunës **Fatmir Iska**: Kuorum për mbajtjen e mbledhjes kemi.

**Kryetari**- Më lejoni ti përshëndes të gjithë të gjithë anëtarët e KKSB, drejtorët e drejtorive, komandantin e stacionit të policisë në Rahovec **z. Fazli Morina**, Përfaqësuesit e organizatave, institucioneve që e përcjellin këtë takim të rregullt të KKSB-së, FSK, KFORI, UNMIKU, OSBE, përfaqësuesit e klerit fetar, , përfaqësuesit e mediave dhe gjithë të pranishmit e tjerë që janë prezent në sallë. Ky është takimi i katërt për vitin 2019 i KKSB-së. Propozoj këtë rend dite:

### REND DITE

1. **Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,**
2. **Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit,**
  - Masat për parandalimin e lëmshë-kërkuesit,
  - Plani operativ për sezonin e pushimeve të mërgimtarëve dhe dasmave,
  - Gjendja e sigurisë në shkolla,
  - Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimin e planit për siguri në shkolla,
  - Rreth veprimeve dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në komunën e Rahovecit,
  - Parapërgatitja dhe vetëdijesimi i qytetarëve për parandalimin nga zjarri gjatë sezonit veror,
3. **Sensibilizimi i qytetarëve për rendësin e promovimit të bashkëpunimit ndër-etnik, multi - kulturor dhe ndër-fetar,**
4. **Të Ndryshme.**

**Nënkryetari** – Të nderuar do e udhëhoqi sot këtë mbledhje në mungesë kryetarit të komunës, i cili është në ceremoni festive në Prishtinë. Njëkohësisht ju uroj të gjithëve Ditën e Paqes, ditën e çlirimit 12 Qershori. E qes në votim rendin e ditës: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

#### **1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**

Ka dikush të shtoj diçka sa i përket procesverbalit nga mbledhja e kaluar, nëse jo e qes në votim procesverbalit nga mbledhja e kaluar: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar procesverbali nga mbledhja e kaluar. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

#### **2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit.**

**Nënkryetari** – Rreth situatës dhe gjendjes së sigurisë në Komunën e Rahovecit ne pranojmë raporte çdo 24 orë nga stacioni policor në Rahovec, nga këto raporte që na kanë ardhur nuk është parë diçka serioze e cila mundet të cenojë sigurinë në komunën tonë. Për më shumë fjalën ja kalojë komandantit të stacionit policor në Rahovec.

**Fazli Morina** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, siç e thatë edhe ju nënkryetar situata e sigurisë në komunën tonë është e qetë dhe stabile për momentin pa ndonjë ndryshim të veçantë, mundemi të themi lirisht se edhe në zonën e përgjegjësisë të drejtores rajonale që ne i përkasim, konsiderohet se situata e përgjithshme është e qetë dhe stabile. Po ja filloj me masën e parandalimit të lëmshë kërkuesve. Policia e Kosovës ka implementuar Planin Operativ të veçantë lidhur “Lëmshë Kërkuesit”, Njësite përkatëse në kuadër të Stacionit Policor në Rahovec janë angazhuar në vazhdimësi lidhur me këtë dukuri e cila nuk është shumë e theksuar në komunën e Rahovecit krahasuar me Komuna tjera në Kosovë, mirëpo kërkohet angazhim edhe të institucioneve tjera, si QPS, etj. Gjatë periudhës Janar –Maj 2019, nuk është iniciuar asnjë rast të lëmshë kërkimit, ndërsa gjatë vitit 2018 janë regjistruar tre (03) raste, të cilët janë dërguar në gjykatë, por kryesisht këto raste kanë të bëjnë me shtetasit e Republikës së Shqipërisë. Sa i përket Planit operativ për sezonin e pushimeve të mërgimtarëve dhe dasmave, ne jemi në përgatitje të këtij Plan Operativë të veçantë “Sezoni Veror 2019”. Sezoni veror ne vendin tonë ka disa karakteristika të veçanta të cilat kërkojnë aktivitete pro-aktive Operative shtesë nga Policia e Republikës së Kosovës. Gjatë muajve në vijim, e sidomos në muajt Qershor, Korrik dhe Gusht kemi një fluks të madh të bashkatdhetarëve të cilët vijnë në pushim nga vendet e Evropës perëndimore dhe nga vende tjera. Zakonisht shumica prej tyre vijnë me vetura duke shkaktuar një rritje të theksuar të numrit të veturave në rrugët e Kosovës. Nga e kaluara në këtë periudhë kohore kemi edhe rritje të pjesëmarrësve në trafikun rrugor dhe si pasojë e kësaj dihet që kemi edhe aksidente të trafikut të të gjitha llojeve, qoftë me lëndime trupore, qoftë me dëme materiale, por ajo më e keqja është se kemi edhe aksidente me fatalitet. Pastaj siguria në trafikun rrugor apo aksidentet, Jemi dëshmitarë për dendësinë në qarkullim të mjeteve motorike nëpër rrugë të Kosovës. Kjo ndodhë për faktin se numri i veturave në RKS është rritur, pastaj fillojnë ardhja e bashkatdhetarëve nga jashtë, organizimeve të dasmave, koncerteve, shkuarjes në pushime të qytetarëve të Kosovës jashtë shtetit etj. Ku kemi një shtim të numrit të aksidenteve dhe kundërvajtësve në trafikun rrugor, për shkak të rritjes së numrit të udhëtarëve, këmbësorëve dhe mjeteve motorike si: veturave, motoçikletave, biçikletave të cilat si pasojë e infrastrukturës jo të mirë rrugore dhe punimeve në të, gjithashtu edhe nga pakujdesia shtohet numri i të gjitha llojeve të aksidenteve dhe kundërvajtësve në trafikun rrugor. Dukuri tjetër në komunikacion është edhe vënja në lëvizje e makinerisë bujqësore, të cilat tani përdoren me të madhe nga bujqit të cilët fillojnë me mbjelljen e kulturave të ndryshme bujqësore, duke e ditur se Komuna e Rahovecit është vend bujqësorë. Pastaj Fëmijët por edhe të rriturit të cilët janë pjesëmarrës në komunikacionin rrugor qoftë në këmbë apo edhe me mjete motorike, biçikleta, motoçikleta etj, janë të ballafaquar me situata të ndryshme siç janë: veturat e parkuara në trotuare, kalimi në udhëkryqe me semafor dhe pa semafor, si dhe mos respektimit, njohjes në përgjithësi të shenjave, rregullave të komunikacionit rrugor. Gjatë muajve në vijim ka një Gjatë muajve në vijim kemi një shtim enorm të dasmave, ahengjeve dhe gazmendeve familjare të cilat në shumë raste përcillen me të shtëna nga armët e zjarrit dhe me kolona të gjata të dasmoreve të cilët vozisin duke mos respektuar fare rregullat e trafikut. Në shumë nga këto manifestime familjare kemi pasur edhe raste tragjike si humbje të jetëve dhe plagosje qofte si pasojë e përdorimit të armeve të zjarrit apo kundërvajtjeve në trafikun rrugor. Përdorimi i armeve të zjarrit nga persona të pa autorizuar paraqet një kërcënim serioz për jetën e pjesëmarrësve në këto ahengje dhe njëkohësisht shkaktim të rrezikut të përgjithshëm, pasi që shpesh here ka ndodhur që nga plumbat qorr të lëndohen edhe viktimat të rastit të cilat kanë qenë në distance nga vendi ku është ber gjuajtja, përkatësisht ku është mbajtur ahengu. Sa për kureshtje mundem të ju them se një rast i tillë para 2 ose 3 viteve ahengu ka qenë në tek ura e Fshejtë, kurse personi i plagosur ka qenë në fshatin Gexhe. Do të kalojë tek zjarret dhe zjarrëvëniet, në bazë të statistikave të rasteve dhe përvojës ne të kaluarën, gjatë kësaj sezone kemi raste të zjarreve dhe zjarrëvënjeve neper male, shtëpi dhe fusha duke shkaktuar dëme të mëdha materiale si dhe duke rrezikuar jetën e njerëzve dhe të shtazëve. Këto në të shumtën e rasteve janë të shkaktuara nga dora e njeriut qofte nga pakujdesia apo ne mënyrë të qëllimshme. Pastaj zhurmat nga lokalet e ndryshme, Është shqetësuese për banoret kryesisht të qyteteve zhurma që shkaktohet nga muzika me ton të larte nëpër kafiteri, klube nate, pishinat, edhe gjatë orëve të vona të natës e deri në orët e hershme të mëngjesit. Sa i përket sigurisë në

shkolla, Policia e Kosovës, sigurisë në shkolla i jep mjaft rëndësi përkundër angazhimeve tjera shtesë, lidhur me këtë implementohet Plan Operativ në vazhdimësi “Siguria në Shkolla”, duke patrulluar në afërsi të objekteve shkollore me automjete zyrtare, duke angazhuar zyrtar në rroba civile, mbahet takime, kontakte të vazhdueshme me drejtorët, zyrtarë tjerë të shkollave përkatëse. Kur jemi tek përfundimi i vitit shkollorë ku organizohen mbremje të ndryshme nga shkollat në nivel fillor dhe atë të mesëm nëpër restorante në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, dhe lidhur me këtë kemi lëvizjen e nxënësve në mënyrë të organizuar për pjesëmarrje në mbremjet e maturave. Mundem të them lirishtë se rasti i fundit ka qenë aspak mirë i organizuar, ne e marrim njoftimin nga drejtorja, aty shihet qartë itinerari i mbajtjes së ahengut, pastaj salla ku do të mbahet organizimi i mbremjes. Por mbledhje e të gjithë atyre në park është një dukuri negative, pastaj shkaktimi i gjithë asaj tollovie në rrugët edhe ashtu në s’ter ngarkuara, gjithçka jashtë kontrolli, ku nuk ka as drejtor e as profesor që merret me ta, prandaj kjo është një dukuri e papranueshme. Gjatë vitit 2018 janë regjistruar 10 raste të ndryshme në objekte shkollore, apo në afërsi ndërsa gjatë vitit 2019 Janar-Maj janë regjistruar katër (04) raste. Për më shumë nëse i intereson dikujt jam këtu për të ju dhënë informata, kemi informata për çdo shkollë. Po ju japë edhe disa informacione rreth disa statistikave për muajin prill – maj 2019, gjatë kësaj periudhe janë regjistruar 80 raste, nga to 65 vepra penale dhe 15 incidente të ndryshme krahasuar me përdhën e njëjtë të vitit të kaluar. Rastet më të rënda të cilat janë regjistruar gjatë kësaj periudhe është vrasja 09.05.2019 në ora 16:00, ku jemi njoftuar për mes telefonit, pastaj e kemi pasur një rast të lëndimit të rëndë trupor, pastaj vjellje kemi pasur dy raste, vjellje e rëndë 21 raste. Gjatë periudhës prill – maj 2018/2019, janë regjistruar 23 vjellje, pastaj janë implemetuar gjithsej 32 plane operative të ndryshme. Asistime nga ana e policisë në total qoftë kuvendit të komunës apo institucioneve të tjera gjithsej 38 raste. Në muajin maj janë arrestuar gjithsej 38 persona, nga ta 16 janë ndaluar për mbajtje për 48 orë. Urdhëresa nga gjykata prill – maj 2019 janë të realizuara 103 raste, pastaj aksidente të trafikut 8 raste, kurse gjoba në komunikacion kemi 801 gjoba, në vitin 2019 edhe pse numri i tiketave ka pasur një ramje shumë të madhe krahasim me vitin e kaluar, por është fat i mirë që numri i aksidenteve është në zvogëlim këtë vite.

**Nënkryetari** – Ju faleminderit i nderuar komandant për këto informata, të nderuar anëtarë të KKSB debati është i hapur dhe fjala është për ju.

**Gonete Mustafa**- Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, vijë nga Qendra për Punë Sociale, institucion që në veprimtarin e tij e ka kategorinë e fëmijëve lëmshë kërkues. Në bazën e të dhënave të shërbimit social në Rahovec janë të evidentuar një numër mjaftë i vogël i fëmijëve lëmshë kërkues, por në praktik mendoj se është një numër më i madh i lëmshë kërkuesve. Qendra për Punë Sociale në Rahovec në bashkëpunim me stacionin policor të Rahovecit, kanë realizuar një projekt në lidhje me identifikimin e këtyre rasteve dhe parandalim e tyre. Gjatë evidentimit të këtij projekti kanë arritur që të evidentojnë një numër të konsiderueshëm të rasteve, mirëpo assesi punëtorët social nuk kanë arritur që ti bindin prindërit e këtyre fëmijëve që të kyçin në sistemin arsimor si masë preventuese për parandalimin e fëmijëve në lëmshë. Si masë tjetër preventuese e realizuar ka qenë kuqja e këtyre fëmijëve në skemën e asistencës sociale, pastaj seancat e vazhdueshme këshilluese që mbahen me prindërit e këtyre fëmijëve, por kur e shikojmë realitetin rezultati është mjaftë i vogël. Është formuar Komiteti i Veprimit në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, ky komitet është në fazën fillestare të saj, janë duke u mbajtur trajnime në Prizren, shumë shpjete do të hartohet edhe Plani i Veprimit i cili do të prezantohet në kuvend. Për këtë plan duhet të ekzistojë një buxhet i paraparë, por kjo varet nga kuvendi a e miraton apo jo. sa i përket asaj se cilit komunitet i përkasin këta fëmijë, në bazë të statistikave dhe të dhënave që i ka QPS-ja, 80% janë nga komuniteti RAE, 20% nga komuniteti shqiptar, kurse serb nuk ka asnjë.

**Fazli Morina** – Arsyeja pse unë e përmenda QPS-në është për të mirë, e jo në aspektin negativ, e them këtë që mos të keqkuptohemi, kurse Planin e Veprimit nuk e përmenda sepse nuk isha në rrjedha, sepse ka vetëm dy muaj që jam në këtë detyrë.

**Shaip Shala** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, e përgëzoj komandantin për këtë raport që na ofroi rreth gjendjes së sigurisë në Komunën e Rahovecit, ne para disa dite e kemi pasur një incident në

palestrën sportive në Rahovec. Pyetja ime është: Sa delikuent të asaj dite kanë kaluar nëpër procedurat e juaja të cilat kanë bërë shkelje të rregullave, edhe pse besoj se nuk janë shumë. Pastaj, sa është e pranishme narkomani në Komunën e Rahovecit, a keni ndonjë shifër, para disa dite e kemi pasur një rast ku është kapur një sasi e madhe e drogës në Rahovec, dhe sigurte se kjo drogë e ka pasur destinacionin e vetë, nëse ka mundësi të na jepni ndonjë informatë.

**Fazli Morina** – I nderuar ashtu siç ke qenë ti prezent dhe gjithë ata dashamirë të sportit në sallë, kam qenë po ashtu edhe unë prezent në të gjitha ndeshjet që janë zhvilluar. Është shumë e vërtet se në ndeshjen e fundit ka pasur prishje të rendit dhe qetësisë publike, por për ato veprime policia është angazhuar ku i ka marrë disa persona, ku pastaj janë intervistuar dhe janë kompletuar rastet. Përveç rasteve për kundërvajtje të prishjes së rendit dhe qetësisë publike, për këta të njëjtit është iniciuar edhe rasti penal, ku rasti ka përfunduar në gjykatë. Kurse sa i përket rastit për narkotikë që është konfiskuar më shumë se 60 kg, saktë as unë nuk e di sa ka qenë, ku ka qenë destinacioni nuk e dimë as ne, rasti i takon sektorit që merret me narkotik në DRP – Gjakovë, ata janë mare drejtpërsëdrejti me këtë rast, me asistencën e policisë së stacionit të Rahovecit. Është një fat i madh që parandaluar kjo sasi dhe është ndalur destinacioni i tyre.

**Bujar Morina** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, desha të ndërlidhem sa i përket temës së parandalimit të lëmshë kërkuesve, e dëgjova me shumë vëmendje punonjësen e QPS-së, e cila tha se 80% e lëmshë kërkuesve janë nga komuniteti RAE, të nderuar nuk ka komunitet RAE por ka komunitet Romë, Ashkali dhe Egjiptas. Pastaj për tu parandaluar lëmshë kërkuesit e këtij komuniteti duhet që të i punësohen prindërit e tyre dhe të jepet mirëqenia sociale, e jo nëse punojnë 1 ose 2 muaj të i ndërpritet ndihma sociale, asnjë prind nuk ka dëshirë që fëmija i tij të shtrijë dorën që të kërkojë për të ngrënë. Prandaj kërkoj nga zyrtarja QPS-së që këto komunitete të cilat ajo është duke i quajtur RAE e që nuk jemi ne RAE, të i merë më shumë parasysh sepse me shumën që e ndahen nga ndihma sociale as një javë nuk mundesh të mbijetosh.

**Nënkryetari** – Do i përgjigjem z. Bujar Morinës sa i përket kontratave për shërbime të veçanta që lidhen për 3-6 muaj, i nderuar janë rregullativat ligjore që i rregullojnë këto, nëse është përfitues i skemës sociale. Atij i ndërpritet ndihma sociale për ato muaj sa është duke punuar, kurse pas ta kryej kontratën e punës i rikthehet skemës sociale. Kurse sa i përket termit RAE, i nderuar zyrtarja e QPS-së nuk e ka zbuluar këtë term, ky term përdoret në tërë Republikën e Kosovës, dhe zyrtarja pa kurrfarë qëllimi të keq e ka përmendur këtë shkurtesë, përndryshe ne të gjithë e dimë që është komuniteti Romë, Ashkali dhe Egjiptas.

**Nysret Abazibra** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, desha të kyçem rreth kësaj pike të rendit të ditës, sa i përket lëmshë kërkuesve, ne si bashkësi islame jemi më së shumti nga institucionet të prekur, ngase lëmshë kërkuesit zakonisht i frekuentojnë këto objekte. Por ne si bashkësi islame kemi shqetësime nga veprimtaria e tyre, prandaj ne në këtë pikë kishim kërkuar edhe ndihmën e policisë, ngase koha kur vinë ata është e ditur, është dita e xhuma dhe në kohët e namëzave, e posaçërisht në kohën e drekës. Është mirë që të mëremi me këtë problem sepse këta fëmijë kanë prindër, është mirë që të bisedohet me ta, nëse nuk mundeni të mëreni vesh në fund duhet të zbatohet ligji. Sa i përket gatishmërisë sonë që ti ndihmojmë këtyre familjeve, ne jemi të gatshëm, ne edhe ashtu jemi duke i ndihmuar sepse këto familje janë në listën tonë, ku ne i japim ndihmë gjatë muajve të ramazanit dhe festave tjera. Është mirë që të ndërmerret një lloje aksioni sepse qe disa vite është duke u biseduar për këtë problem, por i njëjti problem është duke vazhduar pa kurrfarë ndërhyrje, ka raste që hynë edhe brenda në xhami ku na shqetësojnë dhe nuk mundemi që të i kryejmë ceremonitë fetare si duhet. Ajo që më ka rastisë të shohë është kërkimi i ndihmave nëpër lokale, furra etj. ku është lëmë një kuti e qelqit dhe kërkohet që të vendosen të hodha. Kishte me qenë mirë që institucionet përkatëse të i verifikojnë adresën e këtyre personave që i mbledhin këto ndihma, më ka rastisë të shohë logon e një OJQ- në këto kuti me emrin Duart që Ndihmojnë, është mirë të dihet se kush është kjo OJQ, dhe për çfarë i tubon këto ndihma. Sa i përket pikës së cekur rreth dasmave, komandanti i policisë na shpjegoi më shumë rreth sigurisë, por a ka ndonjë mundësi të gjendet ndonjë formë se si ne të shpëtojmë nga zhurma e muzikës në këtë sezon. Ka familje që në shtëpi kanë të sëmure, pastaj ka njerëz që duhet të

zgjohen në mëngjes për punë, kurse nuk mundën të flenë deri në orët e vona nga muzika, ne po mundohemi që të rregullojmë shumë gjëra që të shkojmë në Evropë, është mirë që edhe këtu të vihen do ligje, pastaj ndoshta edhe të dënohen këta që prishin rendin dhe qetësin publike. Ne edhe më herët kemi kërkuar statistikat e përdoruesve të narkotikëve, kisha pas dëshirë të di statistikat për komunën e Rahovecit, se sa persona janë përdorues të narkotikëve zyrtarisht. Për fund në qendër të Rahovecit e kemi një qeshmë e cila rrjedhë ujë tanë kohën, ne si bashkësi islame jemi më të prekur nga ky ujë sepse i kemi zyrtat afër, sa herë që dalim në rrugë duhet të kemi kujdes mos na stërpikë ndonjë makinë. Kishte me qenë mirë nëse keni mundësi diçka të bëhet rreth kësaj problematike, besoj se kjo do të kontribuonte edhe pasqyrës së Rahovecit, sepse në këtë pjesë është qendra dhe nuk ka mundësi që dikush të vije në Rahovec e mos të kalojë në këtë rrugë.

**Enis Berisha** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, do të flasë rreth temës së fëmijëve lëmoshë kërkueseve edhe si drejtor shkolle, por edhe si anëtar i KLSP-së. Ne si shkollë kemi pas rastin që të bashkëpunojmë edhe me organizatën e SHL-Kosova, ku ju është ofruar edhe ndihma materiale mësimore, pastaj edhe një shujtë për disa vite. Sa i përket kushteve dhe mundësive që i kanë këta fëmijë për mundësin e vijimit të shkollës, lirishtë mundem të them se i kanë pasur, sidomos në shkollën fillore “Gëzim Hamza – Piktori”, ne kemi pasur edhe fushatë të regjistrimit, fushatë në sigurimin e çantave, librave, fletorëve, veshmbathje etj. po ashtu ka pasur edhe mësim plotësues për të gjitha at nxënës që kanë ngecur, ose për ata që e kanë tejkaluar moshën dhe nuk kanë pasur mundësin që të vijojnë mësimin e rregullt. Do të ishte mirë që të bëhet një fushatë më e gjerë dhe të ndikohet më tepër, por mendoj se kjo më shumë i bie barë familjarëve të tyre, neve na kanë ardhur disa kërkesa nga disa fëmijë që i kanë nga 17-18 vjet që nuk e kanë të kryer as klasën e 4 ose të 5, nuk kishim mundësi që të japim më shumë dokumentacion që të regjistrohen në qendrën e punësimit. Është mirë që të gjithë institucionet të i ndërmarrin të gjitha masat pa e lënë anësh këtë problematik, dhe të ndikohet që këta fëmijë të jenë në shkolla e jo në rrugë si lëmoshë kërkues. Sa i përket KLSP-së ne mundemi në mbledhjen e ardhshme ta diskutojmë dhe të paraqesim para jush edhe para kuvendit një plan të veprimit në mënyrë që të ndihmojmë në zhdukjen e kësaj dukurie.

**Nënkryetari** – Sa i përket pikës së dytë të rendit të ditës është fol mjaftë, këtu është zyrtarja e QPS-së, pastaj zyrtarët nga stacioni policor etj. Është folur për planin operativ për sezonin e mërgimtarëve dhe të dasmave, gjithçka qëndron ashtu i nderuari hoxhë për këto janë të rregulluara edhe me ligj që pas orës 24:00 është e ndaluar, por për këtë janë organet e tjera që duhet të kujdesen. Sa i përket gjendjes së sigurisë në shkolla komandanti i stacionit policor e dha një[ raporte të vogël, po ashtu edhe për planin operativ, nëse ka diçka të shtojë rreth kësaj drejtori i DKA-së fjalën do ta ketë. Sa i përket parandalimit të zjarreve ne si komunë e kemi bërë një planë operativ, drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim do ju thotë më vonë disa fjalë rreth kësaj teme. Sa i përket muajit të mërgimtarëve, komuna zakonisht cakton një sportel të veçantë, pastaj krijon disa lehtësira tjera sikurse parkingun që është pa pagesë dhe disa lehtësira të tjera mos të hyjë tani të i përmendi me radhë.

**Përparim Krasniqi** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, do të lidhem pak me atë që e tha kapiteni sa i përket çështjeve të gropave në qytet, i nderuar jam i informuar rreth kësaj, janë duke u formuar disa gropa për arsye të gypave të vjetra që janë instaluar në kohërat e mëhershme në qytet, dhe zakonisht kur ka deformime të këtyre gypave formohen disa gropa që me të vërtet janë të rrezikshme. Ne e kemi autorizuar kompaninë për intervenime emergjente që të intervenoj, ku disa janë rregulluar, por janë disa tjera që duhet të trajtohen me kujdes. Po ashtu kemi filluar edhe me mirëmbajtjen e rrugëve në Rahovec, në disa segmente rrugore e kemi hekur shtresën e asfaltit dhe e kemi vendosur asfaltin e ri, pritret që gjatë vikendit të bëhet edhe shenjëzimi i rrugëve, kërkujmë edhe ndihmë nga policia e Kosovës që të na asistojë gjatë shenjëzimit të rrugëve horizontale dhe vertikale. Sa i përket shqetësimit, i nderuar me të vërtet kemi një anarki në qendër të qytetit, për veç parkingut që është pa standardë, pastaj problemi seriozë është se transportet e rënda që qarkullojnë në qendër, për shkak të pamundësisë që të kalojnë rreth rrotullimin kalojnë mbi te, pastaj rrethi dëmtohet, ne dy herë kemi ndërhy në rregullimin e këtij rreth rrotullimi. Ne mundësi nuk kemi që ti largojmë objektet por mundësin që ti largojmë veturat i kemi, kryetari i komunës mbase kërkesës së adresuar nga policia e

Kosovës ka filluar që të kontraktojë një kompani për auto bartje, jemi në fazën e procedurave dhe shumë shpejtë kjo do të kryhet. Kurse sa i përket ujit që është duke rrjedhur vazhdimisht në qendër, ne kemi problem me disa njerëz të pandërgjegjshëm ku janë duke e bllokuar pusëtën, me arsye që uji të lëviz në rrugë dhe të krijohet një freski gjatë verës për bizneset që janë afër. Dy ose tre herë inspektorati i ka bërë procesverbalet ku i kemi debllokuar kanalizimet, por përsëri njëjtë e kanë bllokuar, por ne e kemi kontratën dhe shumë shpejtë do ta trajtojmë edhe këtë pjesë ku do të bëhet asfaltimi i kësaj pjese sepse është bërë një qarje aty.

**Hasan Përboqi** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, pasi që tani jemi në sezonin verore ose si q quajmë ne sezon e pikës së nxehtë, ne si drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim e kemi hartuar një plan operativ për vetëdijesimin e qytetarëve për parandalimin e zjarreve për gjatë sezonës verore. Fletushkat e përgatitura nga drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim do të shpërndahen nëpër çdo institucion publik, po ashtu edhe në rrugët ku është frekuentimi më i madhe i qytetarëve. Në këtë fletushka përfshihen informatat si numri emergjent i cili është pa pagesë, pastaj janë edhe disa rekomandime në rast të kaplimit të zjarrit, pra cila rekomandime duhet të i ndjekin qytetarët në mënyrë që dëmi të jetë më i vogël tek ai. Në fund ju njoftoj se për sezonën e verës drejtoria për Mbrojtje dhe shpëtim është furnizuar edhe me një kamion të ri për zjarrfikës dhe shpëtim, shpresoj se gjatë javës së ardhshme do të pajisemi edhe me një kamion tjetër të ri i cili do na vije si donacioni nga zjarrfikësit e Francës për komunën tonë.

**Avni Morina** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, sa i përket sigurisë në shkolla për këtë periudhë raportuese që jemi duke raportuar nuk kemi pasur ndonjë problem të theksuar, një çështje e cila duhet trajtuar edhe në të ardhmen është organizimi i mbrëmjeve të maturës, për arsye se aty duhet të kërkojmë përgjegjësi jo vetëm nga shkolla por edhe nga prindërit dhe shumë sektorë të tjerë shoqërorë. Ne nuk mundemi të i obligojmë mësuesit që të kujdesen për nxënësit gjatë manifestimit të maturës në parkun e qytetit, pastaj nuk mundemi që të obligojmë prindërit e nxënësve të cilët shkojnë me vetura tek restoranti pastaj nuk ka vend as për veturat tona etj. Pra nevojitet një angazhim të gjitha strukturave, ose të bëhet një thirrje publike-vetëdijësuese, sidomos tek prindërit, edhe pse është fetë për familjet e tyre, por edhe festa duhet të ketë disa rregulla. Organizimi i cili ka qenë tek parku i qytetit nuk ka qenë i organizuar nga shkolla, por ai ka ardhur vetvetiu, pra maturanët janë vetorganizuar, dhe e kuptoj se me këtë kanë shkaktuar një tollovi të panevojshme në qytet. Ne si DKA e falënderojmë bashkëpunimin me policinë e Rahovecit, be kemi vazhdimisht bashkëpunim të vazhdueshëm. Ju njoftoj se asnjë aktivitet jashtë shkollor i shkollave nuk realizohet pa lejen e DKA-së, kjo ndoshta ka ardhur edhe pse në shumicën e shkollave janë të formuar këshilli i arsimtarëve, i prindërve dhe i nxënësve, mendoj se kjo ndoshta ka reflektuar pozitivisht që mos të kemi ndonjë problem sa i përket shkollave në këtë periudhë.

**Nënkryetari** - Ju faleminderit të gjithëve për këto informata që na i dhatë, kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

### **3. Sensibilizimi i qytetarëve për rendësin e promovimit të bashkëpunimit ndër-etnik, multi - kulturor dhe ndër-fetar.**

**Nënkryetari** – Kjo pikë e rendit të ditës na është propozuar gjatë hartimit të planit të punës së KKSB-së nga OSBE-ja, me datë 02.07.2019 do të organizohet një turnirë i volejbollit nga ana e komunës në bashkëpunim me OSBE-në. Në këtë turnirë do të marrin pjesë të gjitha komunitetet që jetojnë në komunën e Rahovecit. Nëse nuk ka askush të shtoj diçka sa i përket pikës së tretë të rendit të ditës, atëherë kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës:

### **4. Të Ndryshme.**

**Nënkryetari** – Të nderuar dua të ju njoftoj se në komunën tonë do të organizohet ushtrimi fushor nga FSK-ja nga data 25 – 27 Qershor, po ashtu do të filloj edhe aksioni për lirimin e trotuareve që nga dita e nesërme. Nëse ka dikush të shtoj diçka sa i përket kësaj pika fjala është e juaja.

**Ramë Berisha** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, ne anëtarët e KKSB-së jemi të ftuar në këtë këshill që të ju njoftojmë për raste dhe nevojat e ndryshme që na preokupojnë neve si komunitet. Ne si komunitet i fshatit Xërxë kemi nevojë për rregullimin e një rruge sepse gjatë reshjeve kjo rrugë është e

pakalueshme, drejtori i shërbimeve publike na ka premtuar që kjo rrugë do të rregullohet, dhe ne i besojmë drejtorit ku shpresojmë që shumë shpejtë do ja nisin punimet për rregullimin e kësaj rruge.

**Fadil Sylka** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, dua të ngrisë një shqetësim ku besoj se edhe ju do të pajtoheni, së pari do ja filloj me një kritikë ndaj klerikëve fetar, e kisha pyetur klerikun z. Nysret Abazibran a mbajnë ndonjë ligjëratë për xhematin e tyre kur vinë në xhuma me makina dhe i parkojnë makinat e tyre në qendër, a i thotë xhematit që nuk duhet të parkojnë makinat në qendër sepse janë duke bërë pengës në qarkullimin e komunikacionit. Posaçërisht në ditën e xhuma është duke u shkaktuar një tollovi në qendër të qytetit për shkak të parkingut të veturave, prandaj është mirë që klerikët fetar të i mbajnë ligjëratat xhematit të tyre që makinat të i parkojnë në ndonjë parking dhe të vinë pastaj të i kryejnë ceremonitë fetare. Nuk e kam fjalën vetëm në qendër por ne po kemi pengesë të qarkullimit në disa vende të qytetit, prandaj kisha kërkuar nga policia që në atë kohë të mbajë një rend në komunikacion.

**Nysret Abazibra** – Sa i përket parkingut të veturave nuk e besoj se janë të gjitha të xhematit tonë, por janë vetura të gjithë qytetarëve të Rahovecit, por besoj se për ditën e xhuma duhet të kihet një mirëkuptim sikurse që kemi mirëkuptim për ndonjë festë. Në qendër janë dy teqe, pastaj janë dy xhami afër njëra tjetrës, kurse sa i përket apelit i nderuar ne i bëjmë apel xhamtit, por është e perealizueshme sepse nuk kanë ku ti dërgojnë veturat sepse numri është i madhe që vinë si në xhami apo në teqe. Prandaj mendoj se duhet të kemi një mirëkuptim dhe mos të mirët sikurse ka diçka këtu të qëllimshme, por është diçka e domosdoshme që është duke na ndodhur.

**Fadil Sylka** – Është shumë e pakuptimtë që secili të vije me makinë për ta falur xhumanë, munden makinat të i parkojnë në parkingje si tek Hotel Parku ose në ndonjë parking tjetër dhe të vijnë në këmbë në xhami ose teqe. Ne mundemi të kemi mirëkuptim për ndonjë festë që është një herë në vit por jo për çdo javë, kjo besoj se është e tepërt, nuk kam asgjë kundër askujt por është në pyetje vetëdijesimi i qytetarëve.

**Bujra Morina** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kam disa pyetje për hoxhën, i nderuari në shumë takime kërkon që të luftohen lëmosh kërkuesit, pasi është një udhëheqës i fesë islame desha ta pyes hoxhën: I dërguari i Allahut a i ka luftuar lëmosh kërkuesit apo i ka ndihmuar ata. Sipas meje dhe fesë islame lëmosh kërkuesit të cilët kanë nevojë të ndihmohen duhet të ndihmohen e jo siç thotë hoxha të luftohen.

**Nënkryetari** – Besoj se nuk ka nevojë për replikë, sepse kjo nuk është temë e cila duhet të trajtohet këtu, për këtë është policia e Kosovës, për këto tema janë institucionet e veçanta që merren e jo prijësit fetar.

**Nysret Abazibra** – Nuk dua të bëjë replikë por desha të japë një lloj sqarimi dhe vetëdijesimi sepse besoj se do ti shërbej edhe komunitetit të cilit i takon. I nderuar padyshim njerëzit që janë nevojtar duhet të ndihmohen, por unë kam informata dhe përjetime personit që fëmijët e tij po kërkojnë lëmosh ai është konsumues i alkoolit dhe me ato para ai shkon blenë alkool dhe bënë qejfe. Prandaj i nderuar ka dallim të madhe në mes njerëzve që janë nevojtar dhe njerëzve si puna e këtyre që e përmenda më lartë, ne jemi pro që ti ndihmohet nevojtarëve, po ashtu ne jemi prej prijatave që të bëhet një listë dhe si shoqëri të organizohemi që ti jepen ndihma mujore, ne si bashkësi islame jemi të gatshëm të kontribuojmë, por jo në formën siç është duke ndodhur sepse po ka keqpërdorime të mëdha.

**Ramë Berisha** – Me të vërtetë me këta lëmoshë kërkuesit është bërë një tollovi, si nëpër rrugë dhe qytete të ndryshme, tani janë duke ardhur edhe nga Shqipëria, prandaj kisha kërkuar që të bëhet një komision që të bëjë një regjistër për njerëzit që kanë nevojë dhe ata që janë duke kërkuar lëmoshë ato mjete a i përdorin për familje apo i keqpërdorin për gjëra negative.

**Fazli Morina** – Janë të vërtete të gjitha ankesat që janë duke i parashtruar anëtarët e KKSB-së sot në këtë mbledhje, do të flasë pak rreth parkingjeve në qendër dhe rreth lëmosh kërkueseve. Të nderuar janë organet të posaçme që merren me ta nuk kemi nevojë të lëshohemi në debate individuale, ne do të mundohemi të gjithë që ti eliminojmë këto dukuri negative. Sa i përket qendrës po e shpreh pakënaqësinë e stacionit të policisë në Rahovec dhe timen personale, parkingjet në qendër të Rahovecit edhe ato pak që janë të anulohen të gjitha, pra në qendër të mos ketë parking për asnjë automjet. Kurse

sa i përket mbështetjes së policës për ditën e xhuma do të keni i nderuar sa i përket parkingjeve dhe lëmshoh kërkuesve, të jeni të bindur se çdo rast do të trajtohet në mënyrë të barabartë për të gjithë. E përmendët se që nga nesër do të fillojë do të fillojë aksioni për lirim të trotuareve, e them parimisht këtu se mbështetja jonë do të jetë gjithmonë dhe do të i përgjigjemi çdokujt pasi të vlerësohet kërkesa, sepse ene kemi kërkesa të ndryshme. Por nëse vazhdohet sikurse në të kaluarën që të lirohet një pjesë e trotuarit, kurse pjesa tjetër jo atëherë në këtë drejtim mbështetje nga ana jonë nuk do të ketë. Jam pro asaj që të lirohen trotuaret në përgjithësi kudo ato që janë dhe çfarëdo qoftë biznesi që ka përgjatë rrugës kryesore. E di që ka shqetësime të mëdha nga bizneset, por problemi i ynë nuk është që të shikojmë ne se si i shkon atik konsumatori me automjet apo në këmbë, ne duhet të mbajmë rregull, të ofrojmë siguri dhe lëvizje të lirë sidomos për fëmijët. I nderuari drejtor i DKA-së ju falënderoj për fjalët e mira që i thatë, ne i kemi mare një njoftim sa i përket organizimit të maturanteve në park, ku na është thënë se do të festohet me muzike etj, se nuk më kujtohet tash në detaje. Kjo është praktik që është duke vazhduar nga vitet e kaluara, por ndoshta nuk është keqe me dhënë një propozim, mendoj se shumicave që jemi këtu sot na ka rënë të shkojmë jashtë shtetit të Kosovës dhe të shohim se si bëhen organizimet e maturës atje. Mu a më ka rënë rasti të shohë se si bëhet organizimi nga shkolla, ku maturantët futen në një bus apo rimorkion e kamionit dhe shëtitën në gjithë qytetin, ku bëjnë gjiro dhe i sheh i gjithë qyteti dhe pastaj e kanë vendin e caktuar ku shkojnë për të festuar mbrëmjen. Ajo që është ma e keqja është se ne e dimë që fëmija ynë nuk ka patentë dhe ja japim me dorën tonë makinën, prandaj në të ardhme për këso dukuri nga ana e jonë nuk do të ketë mëshirë, ne do ta zbatojmë ligjin ashtu siç kërkohet.

**Nënkryetari** - Të nderuar me kaq përfundoj takimi i sodit, ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë, mirupafshim në takimet e radhës.

**Mbledhja përfundoi në orën 15:00**

Procesmbajtësi

Skendr Hamza



Kryetar i Komunës

Smajl Latifi